

LIGJ
Nr. 155/2020

PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të kontribuojë në uljen e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë;
- b) të përshpejtojë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, me synim zbutjen e efekteve të dëmshme të ndryshimeve klimatike;
- c) të kontribuojë në përpjekjet globale ndaj ndryshimeve klimatike nëpërmjet plotësimit të detyrimeve të Republikës së Shqipërisë ndaj Konventës;
- ç) të krijojë një kuadër gjithëpërfshirës ligjor dhe ndërinstitucional për ndërmarrjen e veprimeve ndaj klimës në nivel kombëtar në përputhje me legjislacionin e BE-së për ndryshimet klimatike.
- d) t'u bashkohet shteteve që njohin emergjencën klimatike, sipas vendimit të Parlamentit Evropian të 28 nëntorit 2019.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Ky ligj përcakton:

- a) kuadrin e përgjithshëm të politikës kombëtare për veprime ndaj ndryshimeve klimatike;
- b) kushtet e shkarkimeve të gazeve serrë nga burimet e palëvizshme e të lëvizshme, nga produktet dhe substancat;

¹ Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

- Direktivën 2003/87/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 tetor 2003, "Për krijimin e një skeme për tregtinë e lejeve për shkarkimet e gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit dhe që ndryshon Direktivën e Këshillit 96/61/KE", e ndryshuar. Numri CELEX 32003L0887, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 275, datë 25.10.2003, f. 32–46.

- Rregulloren (BE) nr. 525/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 maj 2013, "Mbi mekanizmin e monitorimit dhe raportimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe për raportimin e informacioneve të tjera që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar dhe të Bashkimit Evropian, që shfuqizon vendimin nr. 280/2004/KE", të ndryshuar, Numri CELEX 32013R0525, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 165, datë 18.6.2013, f. 13–40.

- c) kushtet e kapjes dhe të depozitimit gjeologjik të dyoksidit të karbonit;
- ç) kuadrin e masave për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimeve të gazit me efekt serrë në nivelin e sektorëve/burimeve dhe në nivel kombëtar në përputhje me angazhimet kombëtare, financimet e brendshme dhe ndërkombëtare;
- d) kuadrin për pjesëmarrje në veprime ndërkombëtare të klimës;
- dh) ngritjen e sistemit institucional për ndërmarrjen e veprimeve ndaj ndryshimeve klimatike.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Efekte të dëmshme të ndryshimeve klimatike” janë ndryshimet në mjedisin fizik apo biotë që rezultojnë nga ndryshimet klimatike, të cilat kanë efekte të rëndësishme negative mbi përbërjen, aftësinë vetëpërtëritëse, produktivitetin e ekosistemeve natyrore apo të menaxhuara, funksionimin e sistemeve social-ekonomike apo mbi shëndetin dhe mirëqenien e njeriut e të kafshëve blegtorale, si: gjedh, të imta, derra dhe njëthundrakë.
2. “Ndryshim klimatik” është një ndryshim i klimës, që i atribuohet direkt apo indirekt aktivitetit të njeriut, i cili ndryshon përbërjen e atmosferës globale dhe që i shtohet ndryshueshmërisë natyrore të klimës, që vërehet në periudha kohe të krahasueshme.
3. “Sistem i klimës” është tërësia e atmosferës, hidrosferës, biosferës e gjeosferës dhe ndërveprimeve të tyre.
4. “Shkarkime” janë çlirimet nga aktivitetet antropogjene të GES-it dhe/ose prekursorëve të tyre në atmosferë, në një sipërfaqe dhe periudhë kohe të caktuar.
5. “Rezervuar” është një përbërës apo përbërësit e sistemit të klimës ku depozitohet një GES apo një prekursor i GES-it.
6. “Përthithës” është çdo proces, aktivitet apo mekanizëm, që largon një GES, një aerosol ose një prekursor të GES-it nga atmosfera.
7. “Burim” është çdo proces apo aktivitet që çliron një GES, një aerosol apo një prekursor të GES-it nga atmosfera.
8. “Konventa” është Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, miratuar në Nju Jork më 9 maj 1992, që ka hyrë në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 1 janar 1995 dhe ku Republika e Shqipërisë është palë jo e shtojcës I.
9. “Protokolli i Kiotos” është Protokolli i Kiotos i Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, miratuar në Kioto më 11 dhjetor 1997, që ka hyrë në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 30 qershor 2005.
10. “Kapja dhe depozitimi gjeologjik i dyoksidit të karbonit (CO₂)” është një teknologji e ndërmjetme/lidhëse, që synon të kontribuojë në zbutjen e ndryshimeve klimatike. Ajo konsiston në kapjen e CO₂ nga instalimet industriale, transportin e tij në një vend depozitimi dhe injektimin në një formacion gjeologjik të përshtatshëm nën tokë, me qëllim ruajtjen e përhershme.
11. “Gaz me efekt serrë (GES)” janë gazet që gjenden në atmosferë në gjendje natyrore dhe të shkaktuara nga aktivitetet antropogjene, të cilat përthithin dhe rrimetojnë rrezatimin infra të kuq. Lista e GES-it të shkarkuar nga aktivitetet antropogjene, që mbulohen nga ky ligj, është në shtojcën I.
12. “Leje mjedisi që përfshin shkarkimet e GES-it” janë lejet e mjedisit të tipave A dhe B, që përmbajnë edhe kushte për GES-in dhe që lëshohen në përputhje me kërkesat e ligjit për lejet e mjedisit dhe të kreut III të seksionit I të këtij ligji.
13. “Instalim” është një njësi teknike e palëvizshme, ku kryhen një apo më shumë aktivitete që bëjnë pjesë në shtojcën II, pjesa A e këtij ligji, dhe çdo aktivitet tjetër shoqëruar që ka lidhje teknike me aktivitetet e kryera në atë vendndodhje dhe që mund të ketë ndonjë efekt mbi shkarkimet dhe ndotjen;

14. “Ton ekuivalent dyoksid karboni” është një ton metrik dyoksid karboni (CO₂) ose një sasi e çfarëdo GES-i tjetër të listës në shtojcën I, që ka potencial ekuivalent për ngrohje globale.

15. “Djegje” është oksidimi i lëndës djegëse, pavarësisht mënyrës sesi përdoret nxehtësia, energjia elektrike apo mekanike e prodhuar nga ky proces, dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet drejtpërdrejt me të, përfshirë pastrimin e mbetjeve të gazta;

16. “Politika dhe masa” janë të gjitha instrumentet që synojnë të zbatojnë angazhimet që lidhen me zbutjen e ndryshimeve klimatike, duke kufizuar shkarkimet antropogjene të GES-it dhe mbrojtjen e shtimin e përthithësve e të rezervuarëve dhe që mund të përfshijnë edhe ato që nuk kanë si objektiv parësor kufizimin dhe reduktimin e shkarkimeve të GES-it.

17. “Investime miqësore ndaj klimës” janë investimet në teknologji, që shkarkojnë pak karbon ose që çojnë në ripërtëritjen e klimës, drejt një ekonomie me pak karbon, që e kufizon ngrohjen globale në 2°C.

18. “Transferim i teknologjisë” është një tërësi procesesh që mbulojnë transferimin e njohurive teknike (*know - how*) të eksperiencës dhe pajisjeve për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen ndaj tyre ndërmjet aktorëve të ndryshëm, si: qeveritë, entet private, institucionet financiare, OJQ-të dhe institucionet kërkimore/arsimore.

19. “Integrim” është integrimi i objektivave, strategjive, politikave, masave apo operacioneve të zbutjes dhe/ose të përshtatjes, në mënyrë të tillë që ato të bëhen pjesë e politikave, të proceseve dhe buxheteve të zhvillimit rajonal e kombëtar në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat.

20. “Përshtatje” janë rregullimet e bëra nga njeriu në sistemet ekologjike, sociale, ekonomike ose proceset politike, në përgjigje të ndryshimeve aktuale apo të pritshme të klimës, efekteve apo ndikimeve të tyre.

21. “Zbutje” janë të gjitha përpjekjet e bëra për të reduktuar apo parandaluar shkarkimet e GES-it, përfshirë përdorimin e teknologjive të reja dhe energjive të rinovueshme, që i bëjnë pajisjet e vjetra më eficiente ndaj konsumit të energjisë, që ndryshojnë praktikën e menaxhimit apo sjelljen e konsumatorit.

22. “Operator” është sipas përcaktimit të dhënë në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.

23. “Operator avioni” është personi që operon një avion në kohën kur ai kryen një aktivitet aviacioni sipas përcaktimit të këtij ligji, me përjashtim të operacioneve të listuara në pjesën B të shtojcës II, ose, kur ky person është i panjohur ose i paidentifikuar nga pronari i avionit, vetë pronari i avionit.

24. “Operator i transportit ajror tregtar” është sipas përkufizimit në ligjin nr. 10 040, datë 22.12.2008, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

25. “Person” është çdo person fizik ose juridik.

26. “Publik” është një ose janë më shumë persona dhe, në përputhje me legjislacionin apo praktikën në fuqi, shoqata, organizata ose grupe personash.

27. “Ministri” është ministri përgjegjës për mjedisin.

28. “Ministria” është ministria përgjegjëse për mjedisin.

29. “AKM” është Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

30. “NDC” është dokumenti i kontributit tonë kombëtar të synuar, në linjë me përpjekjet globale për reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë (GES).

31. “Mekanizmi i zhvillimit të pastër (MZHP)” është një mekanizëm i bazuar në projekte, që buron nga Protokollin e Kiotos dhe që nxit partnerhipin midis vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim të Konventës për arritjen e objektivit final të saj, stabilizimin e GES-it në atmosferë.

32. “Sistemi i inventarit kombëtar” është sistemi i rregullimeve institucionale, ligjore dhe procedurale të bëra në Republikën e Shqipërisë për vlerësimin e shkarkimeve antropogjene nga burimet dhe përthithjen e tyre nga përthithësit e GES-it, të listuara në shtojcën I, si dhe për raportimin dhe arkivimin e informacionit të këtij inventari.

33. "Inventari i GES-it" është inventari i shkarkimeve, që përfshin shkarkimet e GES-it nga kategoritë e burimeve, si dhe përthithjen e tyre nga përthithësit e karbonit.

34. "IGJEUM" është Instituti i Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit.

35. "Konventa e Aarhusit" është konventa për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit, ratifikuar me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000.

36. "Njësitë që përdorin ekskluzivisht biomasën" janë njësitë që përdorin lëndë djegëse fosile gjatë ndezjes apo fikjes së njësisë.

37. "Emergjencë klimatike" është një situatë në të cilën kërkohet veprim urgjent për të zvogëluar ose ndalur ndryshimet klimatike dhe për të shmangur dëmet e mundshme të pakthyeshme mjedisore që rezultojnë prej saj.

KREU II

POLITIKA KOMBËTARE PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

Neni 4

Objektivat dhe parimet

1. Me synimin për të zvogëluar efektet e dëmshme të ndryshimeve klimatike dhe për të kontribuar në përgjigjen globale ndaj tyre, objektivat kombëtarë për ndryshimet klimatike në Republikën e Shqipërisë janë:

a) zvogëlimi i shkarkimeve antropogjene të gazeve me efekt serrë në nivel kombëtar, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare;

b) rritja e aftësisë për t'u përshtatur ndaj efekteve të dëmshme të ndryshimeve klimatike, në nivel kombëtar, qendror e vendor;

c) ruajtja dhe rritja e përthithësve dhe rezervuarëve të gazeve me efekt serrë;

ç) nxitja e zhvillimit ekonomik nëpërmjet krijimit të vendeve të punës dhe konkurrencës, duke përfshirë edhe diversifikimin ekonomik dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;

d) pjesëmarrja graduale në zbatimin e politikës së ndryshimeve klimatike të Bashkimit Evropian.

2. Objektivat e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni zbatohen në funksion të parimeve të mëposhtme:

a) parimi i përgjegjësive të përbashkëta, por të diferencuara, sipas të cilit të gjitha palët e Konventës, pavarësisht nëse janë vende në zhvillim apo të zhvilluara, marrin përgjegjësi për reduktimin e gazeve me efekt serrë sipas kushteve të secilit vend dhe brenda situatës së re ekonomike dhe politike të krijuar;

b) parimi i kujdesit paraprak, sipas të cilit masat duhen marrë, në radhë të parë, për të parashikuar, parandaluar apo minimizuar shkaqet e ndryshimeve klimatike dhe për të zbutur efektet e tyre të dëmshme;

c) parimi i eficiencës, sipas të cilit politikat dhe masat që merren për ndryshimet klimatike duhet të jenë me kosto efektive, në mënyrë të tillë që të sigurojnë përfitime globale me kostot më të ulëta të mundshme;

ç) parimi i integritit, sipas të cilit politikat dhe masat që merren për të mbrojtur sistemin e ndryshimit të klimës nga faktorët antropogjenë, si dhe përshtatja ndaj këtyre ndryshimeve duhet të përfshijnë të gjithë sektorët ekonomikë dhe të mbulojnë të gjitha burimet, përthithësit e rezervuarët e GES-it. Integrimi i ndryshimeve klimatike duhet bërë në të gjitha politikat dhe praktikatat ekzistuese e të ardhshme sektoriale e ndërsektoriale;

d) parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, sipas të cilit masat për mbrojtjen e sistemit të klimës nga ndryshimet antropogjene të integruara në politikën dhe programet e zhvillimit kombëtar duhet të çojnë në rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social të vendit;

dh) parimi i bashkëpunimit dhe financimit kombëtar dhe ndërkombëtar, sipas të cilit përpjekjet për të trajtuar ndryshimet klimatike mund të bëhen bashkërisht dhe në koordinim me vende të tjera të interesuara dhe, përveç buxhetit të shtetit, të mbështeten edhe nga burime financimi ndërkombëtare apo dypalëshe.

Neni 5

Dokumenti Strategjik dhe planet kombëtare për ndryshimet klimatike

1. Dokumenti Strategjik për Ndryshimet Klimatike krijon kuadrin e përgjithshëm kombëtar për veprim ndaj ndryshimeve klimatike dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

2. Plani Kombëtar për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë (NMP) dhe Plani Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP) janë pjesë përbërëse e dokumentit strategjik, i parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Plani Kombëtar për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë (NMP) përcakton masat kombëtare për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe shtimin e përthithësve të GES-it në sektorët përkatës.

4. Plani Kombëtar për Përshtatje krijon kuadrin për një proces të vazhdueshëm të përshtatjes në vend dhe përcakton objektivat për përshtatjen, nxit integrimin e përshtatjes në politikat sektoriale të ministrive të linjës, përcakton masat prioritare dhe organizon përgjegjësitë dhe mekanizmat e bashkëpunimit brenda proceseve të përshtatjes.

5. Krahas kërkesave të tjera për formulimin e strategjive e të planeve, dokumenti strategjik dhe planet për ndryshimet klimatike përfshijnë çështjet nga lista joshteruese sipas shtojcës III-A bashkëlidhur këtij ligji.

6. Ministria nëpërmjet grupit ndërministror të punës në fushën e ndryshimeve klimatike monitoron dhe vlerëson çdo 4 vjet progresin për zbatimin e dokumentit strategjik për ndryshimet klimatike dhe harton raportin, i cili përmban informacionin për:

a) vlerësimin e progresit në reduktimin e shkarkimeve dhe të përthithjes nga rezervuarët e GES-it, në raport me Kontributin Kombëtar të Përcaktuar (NDC);

b) vlerësimin e progresit në zbatimin e Planit Kombëtar të Zbutjes së Gazeve me Efekt Serrë;

c) zbatimin e Planit Kombëtar për Përshtatje ndaj Ndryshimeve Klimatike, që përfshin: gjetjet e reja dhe vulnerabilitetin mbi ndryshimet klimatike; aktivitetet e kryera gjatë procesit të NAP-it; progresin dhe vështirësitë në integrimin e përshtatjes në sektorët e tjerë; progresin dhe vështirësitë në arritjen e objektivave e të indikatorëve; rekomandimet për masat në të ardhmen.

7. Dokumenti Strategjik, Plani Kombëtar për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë (NMP) dhe Plani Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP) rishikohen çdo 4 vjet.

Neni 6

Integrimi i ndryshimeve klimatike në strategjitë sektoriale

1. Për të arritur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit, duke ndjekur njëkohësisht një rrugë me përdorim më pak intensiv të karbonit, ministritë e linjës dhe NJVQV-të me përgjegjësi shtetërore në fusha që kanë ndikim mbi/apo nga ndryshimet klimatike, kanë detyrimin:

a) të integrojnë çështjet e zbutjes e të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në legjislacionin, strategjitë, planet, programet dhe projektet e tyre të zhvillimit, veçanërisht në sektorët e transportit, të energjisë, ujërave, bujqësisë dhe zhvillimit rural, zhvillimit urban dhe menaxhimit të fatkeqësive, si edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;

b) të bashkëpunojnë për zbatimin e legjislacionit, të strategjive, planeve, programeve dhe projekteve që trajtojnë ndryshimet klimatike;

c) të bashkëpunojnë për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e zbatimit të strategjive, planeve, programeve dhe projekteve që trajtojnë ndryshimet klimatike.

2. Masat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni kanë si qëllim të kontribuojnë në:

a) arritjen e angazhimit afatgjatë të vendit për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe rritjen e përthithjes nga përthithësit në të gjithë sektorët, sipas objektivit të caktuar në NDC, në mënyrë sa më eficiente;

b) identifikimin e masave të përshtatshme për uljen e vulnerabilitetit dhe rritjen e aftësive ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike të sektorëve përkatës dhe zbatimin e tyre;

c) monitorimin transparent dhe konsistent të progresit aktual dhe atij të planifikuar për të plotësuar angazhimet e vendit në Konventë.

3. Krahas kërkesave të tjera lidhur me formulimin e strategjive, procesi i integritetit të ndryshimeve klimatike në strategjitë sektoriale përfshin çështje nga lista joshteruese, sipas shtojcës III-B bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 7

Kontributi Kombëtar i Përcaktuar (NDC)

1. Dokumenti i NDC-së përcakton kontributin kombëtar për reduktimin e gazeve me efekt serrë përkundrejt arritjes së objektivit global të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, për mbajtjen e temperaturave në 2°C, duke kufizuar rrezikun e ardhshëm dhe kostot e përshtatjes ndaj ndryshimeve të klimës.

2. Kontributi Kombëtar i Përcaktuar rishikohet çdo 4 vjet dhe, nëse është e mundur, përditësohet me synimin për ta rritur objektivin e reduktimit të gazeve me efekt serrë në atë masë që lejojnë kushtet e vendit.

3. Ministria koordinon me grupin ndërministror të punës në fushën e ndryshimeve klimatike dhe, sipas rastit, edhe me aktorë të tjerë punën për zbatimin dhe rishikimin e dokumentit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

4. Metodologjia për hartimin dhe procesin e përgatitjes së dokumentit të NDC-së miratohet me udhëzim të ministrit, sipas modelit të miratuar ose të rekomanduar nga Konventa, në përputhje me kushtet e vendit.

5. Dokumenti “Përcaktimi i Kontributit Kombëtar” miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit dhe dorëzohet në sekretariatit të Konventës.

KREU III

SHKARKIMET E GES-it NGA BURIMET E LËVIZSHME E TË PALËVIZSHME, PRODUKTET DHE SUBSTANCAT

SEKSIONI I

SHKARKIMET E GES-it NGA BURIMET E PALËVIZSHME

Neni 8

Monitorimi, raportimi dhe verifikimi i shkarkimeve të GES-it nga instalimet

1. Operatori i një instalimi, që kryen cilindo nga aktivitetet e listuara në shtojcën II-A bashkëlidhur këtij ligji, monitoron shkarkimet që kryhen nga instalimi gjatë një viti kalendarik dhe harton raportin e të dhënave të monitorimit të GES-it, të cilin e dorëzon pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit brenda muajit shkurt të vitit pasardhës, në përputhje me rregulloren e parashikuar në pikën 2 të këtij neni. AKM-ja pranon raportin e monitorimit të shkarkimeve të GES-it vetëm nëse raporti është verifikuar nga një verifikues i akredituar.

2. Rregullorja për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimeve të CO₂ dhe gazeve të tjera me efekte serrë nga aktivitetet industriale të listuara në shtojcën II-A të këtij ligji miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit.

Neni 9

Kriteret për përfshirjen e shkarkimeve GES në lejen e mjedisit

1. Operatori i një instalimi të ri, sipas listës në shtojcën II-A të këtij ligji, në aplikimin e tij për leje mjedisi, krahas formularit informues sipas legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit, dorëzon edhe formatin që përfshin informacionin për shkarkimin e GES-it, në përputhje me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji.

2. Operatori i një instalimi ekzistues, sipas listës në shtojcën II-A të këtij ligji, paraqet kërkesën për rishikimin e kushteve të lejes së mjedisit, duke e shoqëruar atë me formatin që përfshin informacionin për shkarkimin e GES-it, në përputhje me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji.

3. AKM-ja lëshon lejen e mjedisit që përfshin shkarkimet e GES-it për të gjithë apo për një pjesë të instalimit nëse operatori është në gjendje të demonstrojë se ka marrë masat e nevojshme që të monitorojë e të raportojë shkarkimet e GES-it sipas kërkesave të rregullores, të parashikuar në nenin 8 të këtij ligji.

Neni 10

Aplikimi për leje mjedisi që përfshin shkarkimet e GES-it

1. Operatori i një instalimi, sipas nenit 9 të këtij ligji, i cili aplikon për leje mjedisi që përfshin shkarkimet e GES-it, sipas përcaktimit të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dorëzon formatin e aplikimit që përmban informacionin për:

a) instalimin dhe aktivitetet e tij, përfshirë përshkrimin rreth teknologjisë më të mirë të mundshme të përdorur, që ndihmon në uljen e shkarkimeve të GES-it;

b) lëndët e para dhe materialet ndihmëse, përdorimi i të cilave mund të çojë në shkarkime të GES-it, të listuara në shtojcën I;

c) burimet e shkarkimeve të GES-it nga instalimet e listuara në shtojcën II-A;

ç) masat e planifikuara prej tij për të monitoruar e raportuar shkarkimet e GES-it në përputhje me rregulloren e parashikuar në nenin 8 të këtij ligji.

2. Informacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni përfshihet në formatin e aplikimit për lejen e mjedisit, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të ligjit në fuqi për lejet e mjedisit.

3. Kur operatori zotëron një ose më shumë instalime në të njëjtën vendndodhje, AKM-ja lëshon vetëm një leje mjedisi, që përfshin shkarkimet e GES-it me kërkesa për këto instalime.

Neni 11

Kushtet që duhet të përmbajë leja e mjedisit për shkarkimet e GES-it

1. Kushtet që duhet të plotësojë një instalim për shkarkimet GES lidhen vetëm me monitorimin dhe raportimin e tyre në përputhje me rregulloren e përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji dhe jo me vendosjen e vlerave kufi për shkarkimet e GES-it apo reduktimin e tyre.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit vendos kushtet që lidhen me monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të GES-it në aktin e miratimit për lejen e mjedisit, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të ligjit në fuqi për lejet e mjedisit.

Neni 12
Ndryshime të instalimeve

1. Operatori duhet të informojë AKM-në për çdo ndryshim që planifikon të bëjë në natyrën apo funksionimin e instalimit ose çdo zgjerim a reduktim të rëndësishëm të kapacitetit të vet, për të cilin mund të nevojitet përditësimi i kushteve të lejes së mjedisit lidhur me shkarkimin e GES-it.

2. Ndryshimi i rëndësishëm i kapacitetit, siç referohet në pikën 1 të këtij neni, nënkupton një ndryshim në funksionim, i cili, sipas gjykimit të AKM-së, arrin pragun e kapacitetit prodhues ose sasinë e prodhimit të një instalimi të listuar në shtojcën II-A të këtij ligji.

3. AKM-ja njofton operatorin kur e sheh të nevojshme përditësimin e kushteve që lidhen me shkarkimet e GES-it. Procedura e përditësimit të kushteve që lidhen me shkarkimet GES është e njëjtë me atë të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për lejet e mjedisit.

SEKSIONI II

Neni 13
Shkarkimet e GES-it nga burimet e lëvizshme

1. Automjetet e reja për pasagjerë dhe automjetet e reja të lehta tregtare vendosen në treg vetëm nëse janë në përputhje me kërkesat e performancës së emetimeve të CO₂, të specifikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave sipas pikës 2 të këtij neni.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për transportin, miraton rregullat e detajuara të performancës së emetimeve të CO₂ nga automjetet e reja për pasagjerë dhe automjetet e reja të lehta tregtare, të cilat përfshijnë:

a) monitorimin dhe raportimin e të dhënave për regjistrimin e automjeteve të reja për pasagjerë për vlerësimin e reduktimit të shkarkimeve të CO₂ nga automjetet e lehta;

b) monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të CO₂ nga automjetet e reja për pasagjerë dhe nga automjetet e reja të lehta tregtare.

3. Automjetet e reja për pasagjerë dhe automjetet e reja të lehta tregtare mund të shiten ose të jepen me qira vetëm nëse janë të shoqëruara me informacionin e duhur për konsumatorin për ekonominë e karburantit dhe emetimet e CO₂.

4. Masat për sigurimin e informacionit për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ gjatë marketingut të automjeteve të reja, sipas pikës 3 të këtij neni, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për transportin.

5. Shkarkimet e CO₂ të lëshuara nga anijet që transportojnë mallra apo pasagjerë për qëllime tregtare, nga porti i tyre më i fundit në një port të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga një port i vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë në portin e tyre të ardhshëm, si dhe në portet që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, u nënshtrohen monitorimit, raportimit dhe verifikimit në përputhje me vendimin e parashikuar në pikën 8 të këtij neni.

6. Çdo operator avioni, i pajisur me licencë nga ministria përgjegjëse për transportin, për fluturimet që nisen nga apo arrijnë në një aeroport që ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë ose midis aeroporteve në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të atyre që listohen në shtojcën II-B të këtij ligji, është subjekt i monitorimit, raportimit dhe verifikimit të shkarkimeve të CO₂.

7. Operatorët dorëzojnë në AKM planin e monitorimit, i cili përcakton masat për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të CO₂, si dhe të dhënat ton-kilometër në përputhje me kërkesat e rregullores të parashikuar në pikën 8 të këtij neni.

8. Rregullorja për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimeve të CO2 nga anijet dhe avionët miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për transportin dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin.

SEKSIONI III SHKARKIMET E GES-it NGA SEKTORË TË TJERË

Neni 14 **Sektori i energjisë**

1. Ministrinë përgjegjëse për energjinë, ekonominë, zhvillimin urban dhe mjedisin nxitin zbatimin e masave për prodhimin e energjive nga burimet e rinovueshme pa karbon, të masave për ruajtjen e eficiencës së energjisë në të gjithë sektorët ekonomikë, përfshirë performancën e energjisë në ndërtesa, masat për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe zbutjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Masa të tilla rregullohen nga legjislacioni për eficiencën e energjisë, për burimet e energjisë së rinovueshme, si dhe nga legjislacioni tjetër i posaçëm.

2. Zhvillimi i strategjive dhe planeve afatgjata, që integrojnë energjinë dhe ndryshimet klimatike, rregullohet nëpërmjet krijimit të një mekanizmi qeverisës, që miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin.

3. Strategjitë dhe planet afatgjata të energjisë dhe klimës përfshijnë objektiva dhe masa për periudhat deri në vitet 2030 dhe 2050, që lidhen me sigurinë energjetike, tregun e brendshëm të energjisë, eficiencën e energjisë, burimet e rinovueshme të energjisë, dekarbonizimin, kërkimin, inovacionin dhe konkurrueshmërinë, si dhe raportimin e progresit të tyre.

4. Plani kombëtar i energjisë dhe klimës për periudhën 2021-2030 miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin.

SEKSIONI IV SHKARKIMET E GES-it NGA PRODUKTET DHE SUBSTANCAT

Neni 15 **Shkarkimet nga lëndët djegëse**

1. Furnizuesit e lëndëve djegëse të lëngëta, përfshirë biokarburantet, monitorojnë dhe raportojnë shkarkimet e gazeve me efekt serrë për njësi të energjisë nga lëndët djegëse gjatë gjithë ciklit të jetës së tyre. Raportet e shkarkimeve janë subjekt i verifikimit përpara dorëzimit të tyre në AKM.

2. Rregullat e detajuara, që lidhen me mekanizmin e monitorimit e të reduktimit të shkarkimeve të GES-it nga lëndët djegëse të lëngëta, miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 16 **Substancat ozonholluese (ODS)**

1. Masat për mbrojtjen e shtresës së ozonit përfshijnë nxjerrjen jashtë përdorimit të substancave ozonholluese dhe zëvendësimin e tyre nga substanca dhe produkte alternative, që janë miqësore ndaj shtresës së ozonit.

2. Për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të

pajisjeve që përmbajnë këto substanca zbatohen rregullat e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të ligjit nr. 26/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”.

Neni 17

Gazet e florinuara

1. Gazet e florinuara janë përdorur si substanca alternative për të zëvendësuar substancat ozonholluese, por ato janë gaze me efekt serrë të fuqishme. Masat për parandalimin, kufizimin, përdorimin, rikuperimin dhe shkatërrimin e gazeve serrë të fluorinuara, si edhe të kushteve për hedhjen në treg të produkteve dhe pajisjeve specifike që i përmbajnë ose funksionimi i të cilave bazohet në gazet serrë të fluorinuara, çojnë në reduktimin e gazeve me efekt serrë.

2. Masat për reduktimin dhe stabilizimin e shkarkimeve të gazeve serrë të fluorinuara miratohen me ligj të veçantë.

SEKSIONI V

PËRTHITHJA, KAPJA DHE DEPOZITIMI I SHKARKIMEVE TË GES-it

Neni 18

Përdorimi i tokës, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyjet (LULUCF)

1. Ministria përgjegjëse për mjedisin, ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe/ose bashkitë projektojnë dhe zhvillojnë politika dhe masa për zbutjen e ndryshimeve klimatike në fushën e pyjeve e të bujqësisë, duke synuar reduktimin e shkarkimeve dhe përthithjen e karbonit nga sektorët e bujqësisë, të pyjeve, përdorimeve të tjera të tokës dhe ruajtjes së ekosistemeve. Në mënyrë të veçantë, bazuar edhe në të dhënat e sistemit të monitorimit të pyjeve, ato angazhohen për:

- a) luftën kundër shpyllëzimeve dhe degradimit të ekosistemeve pyjore për t'i rikthyer ato në gjendjen e mëparshme, për të zgjeruar sipërfaqet e tokës me bimësi dhe me përmbajtje karboni organik, duke zbatuar praktika të menaxhimit të qëndrueshëm në zonat bujqësore;
- b) ruajtjen, zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe shtimin e rezervave të karbonit në pyje;
- c) zhvillimin e programeve për menaxhimin e qëndrueshëm dhe restaurimin e ekosistemeve pyjore, ligatinore e bregdetare-detare;
- ç) përfshirjen e sa më shumë ekosistemeve në planet e ruajtjes (*conservation plans*);
- d) forcimin e luftës kundër zjarreve në pyje;
- dh) projektimin dhe sigurimin e iniciativave ekonomike për përthithjen e karbonit dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura.

2. Bashkitë informojnë çdo vit ministrinë për shpyllëzimet dhe degradimin e pyjeve, që kanë ndodhur në territorin administrativ nën juridiksionin e tyre.

3. Ministria regjistron të dhënat për zonat që kanë pësuar shpyllëzim dhe degradim për shkak të zgjerimit të tokave bujqësore, të kthimit në kullota, të zhvillimit infrastrukturor, të prerjeve të paligjshme dhe zjarreve.

4. Rregullat e përlogaritjes së shkarkimeve të GES-it dhe të përthithjes së tyre, që rezultojnë nga aktivitetet që lidhen me përdorimin e tokës, ndryshimin e përdorimit të tokës e pyjeve, si dhe për informacione të tjera që lidhen me këto aktivitete, miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin dhe të ministrit përgjegjës për bujqësinë.

Neni 19

Kapja dhe depozitimi gjeologjik i dyoksidit të karbonit

1. Operatori i një instalimi të listuar në shtojcën II-A të këtij ligji, që shkarkon CO₂, mund të zgjedhë t'i zbusë këto shkarkime nëpërmjet mënyrave të ndryshme të kapjes dhe depozitimit të tij, si, për shembull, në formacione gjeologjike nën tokë ose përmes veprimeve të tjera që çojnë në këtë rezultat, sipas kërkesave të përcaktuara në vendimin e parashikuar në pikën 2 të këtij neni.

2. Rregullat e kapjes dhe të depozitimit gjeologjik të dyoksidit të karbonit apo në mënyra të tjera miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për minierat dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin.

SEKSIONI VI MATJA, RAPORTIMI DHE VERIFIKIMI I SHKARKIMEVE TË GES-it

Neni 20

Matja, raportimi dhe verifikimi (MRV)

1. MRV-ja nënkupton matjen apo vlerësimin e bërë në Republikën e Shqipërisë, raportimin si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, verifikimin (sigurimin dhe kontrollin e cilësisë) QA/QC në nivel kombëtar, si dhe mbikëqyrjen ndërkombëtare të shkarkimeve/përthithjes ose të dhënave të tjera, që matin performancën, të përcaktuara në:

- a) Raportin Kombëtar të Inventarit të GES-it;
- b) komunikimet kombëtare, raportet e përditësuara dyvjeçare, raportin e NDC-së;
- c) raportet e monitorimit të shkarkimeve të GES-it nga operatorët që kanë këtë detyrim;
- ç) analizën e efekteve të zbatimit të dokumenteve strategjike për ndryshimet klimatike;
- d) projeksionet e emetimeve antropogjene të gazeve serrë dhe përthithjen e tyre;
- dh) investimet dhe mbështetjen financiare për ndryshimet klimatike.

2. Sistemi MRV ngrihet për të rritur transparencën për përpjekjet që bëhen për zbutjen e ndryshimeve klimatike. MRV-ja synon:

a) të masë si përpjekjet për zbutjen e ndryshimeve klimatike, ashtu edhe ndikimin e zbatimit të masave të përshtatshme kombëtare, nivelin e shkarkimeve të GES-it dhe tërheqjen e tyre nga përthithësit, reduktimin e shkarkimeve;

b) të raportojë informacionin e matur në mënyrë transparente dhe të standardizuar nëpërmjet komunikimeve kombëtare, raporteve të përditësuara dyvjeçare (BUR), raporteve të zbatimit të NDC-së, siç parashikohet në nenin 22;

c) të verifikojë e të vlerësojë saktësinë, plotësinë, konsistencën dhe besueshmërinë e informacionit të raportuar nëpërmjet një procesi të pavarur.

3. MRV-ja në Republikën e Shqipërisë do të funksionojë si një sistem me qasje nga poshtë-lart, me të dhëna që monitorohen fillimisht nga operatorët, operatorët e avionëve dhe të anijeve, që janë subjekt i këtij ligji, përfshirë institucionet e varësisë, sipas rastit, të cilat u raportohen ministrive përkatëse të linjës dhe AKM-së, siç përcaktohet në aktet nënligjore që burojnë nga ky ligj. Sistemi MRV do të trajtojë njëkohësisht edhe kërkesat ndërkombëtare.

Neni 21

Monitorimi, raportimi i shkarkimeve të GES-it dhe informacioneve të tjera, që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregulloren për monitorimin, raportimin e shkarkimeve të GES-it dhe të informacioneve të tjera, që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar.

2. Vendimi, i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, krijon:

a) Sistemin Kombëtar të Inventarit të GES-it, duke përcaktuar procedurat kombëtare për grumbullimin, përpunimin, raportimin, verifikimin dhe arkivimin e të dhënave e të informacionit

të kërkuar, i cili duhet të jetë funksional, mbi baza të qëndrueshme e të vazhdueshme, si dhe përcakton organet kompetente;

b) Sistemin e Monitorimit dhe të Vlerësimit (M&V) të masave kombëtare për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike. Nëpërmjet M&V-së synohet ndjekja e progresit në zbatimin e politikave, të planeve adaptuese, ndërhyrjeve e investimeve të përshtatjes dhe/ose sesi këto ndërhyrje po reduktojnë vulnerabilitetin, duke përmirësuar kapacitetin adaptues dhe duke mbështetur mirëqenien e përgjithshme të popullsisë së prekur nga ndikimet e ndryshimeve klimatike.

Neni 22

Raportimet kundrejt Konventës

1. Format kryesore të raportimit të Republikës së Shqipërisë në Konventë janë:

- a) komunikimet kombëtare;
- b) raportet e përditësimit dyvjeçar (BUR);
- c) raporti i zbatimit të NDC-së;
- ç) raporti i inventarit kombëtar të shkarkimeve të GES-it.

2. Kërkesat për përgatitjen e tyre përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave sipas nenit 21, pika 1, të këtij ligji.

KREU IV

AUTORITETET KOMPETENTE

Neni 23

Kuadri institucional dhe koordinimi ndërministror

1. Për të lehtësuar koordinimin efektiv midis të gjithë aktorëve të sektorit publik e privat, për të siguruar një monitorim, raportim e verifikim (MRV) me cilësi të lartë në vazhdimësi dhe në kohë të raportimeve kundrejt Konventës dhe për të trajtuar çdo masë tjetër për ndryshimet klimatike bëhen rregullimet institucionale si më poshtë:

a) ministria është pika qendrore kombëtare e Konventës dhe institucioni përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm dhe menaxhimin e sistemit MRV, përfshirë koordinimin e procesit të përgatitjes së komunikimit kombëtar, të raporteve të përditësimit dyvjeçar (BUR) dhe raportit të zbatimit të NDC-së;

b) AKM-ja është autoriteti kompetent kombëtar për të gjitha aktivitetet që lidhen me ngritjen dhe mbajtjen e Sistemit Kombëtar të Inventarit, si pjesë e sistemit të informacionit mjedisor;

c) ministritë e linjës, kompetencat e të cilave bien në fushat e përgjegjësisë shtetërore që ndikojnë apo ndikohen nga ndryshimet klimatike, sipas rastit, grumbullojnë dhe mbajnë të dhëna për aktivitete, tregues specifikë/tematikë të grupuar dhe informacion që lidhet me klimën e i ofrojnë ministrisë kontributin e tyre me shkrim në përputhje me kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave të parashikuar në nenin 21 të këtij ligji. Ato marrin pjesë në përgatitjen dhe deri në finalizimin e miratimit të të gjitha dokumenteve, si dhe në raportimet, sipas nenit 22 të këtij ligji, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

ç) INSTAT-i ka detyrimin t'i ofrojë ministrisë të gjitha të dhënat social-ekonomike të popullsisë dhe të tjera që lidhen me to;

d) operatorët, që janë subjekt i këtij ligji, dhe institucionet publike, aktivitetet e të cilave bien në fushat e përgjegjësisë shtetërore që jepen në pikën 2 të këtij neni, grumbullojnë, organizojnë dhe mbajnë, sipas rastit, të dhënat e tyre për klimën, bashkë me raportet përkatëse, dhe i vënë në dispozicion të ministrisë përkatëse;

dh) ministritë e tjera të linjës dhe institucionet publike/private, aktivitetet e të cilave nuk bien në fushat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, kontribuojnë, sipas rastit, me kërkesën e ministrisë;

e) IGJEUM-i, institutet e tjera kërkimore-shkencore, si dhe universitetet publike ose private, që kryejnë matje, kërkime apo studime për klimën, i vënë këto në dispozicion të ministrisë/AKM-së, duke iu njohur e drejta e autorit sipas legjislacionit në fuqi;

ë) bashkitë, për territorin nën juridiksionin e vet, grumbullojnë, organizojnë dhe mbajnë të dhënat e tyre për klimën së bashku me raportet për masat e marra ose të planifikuara për zbutjen dhe adaptimin e i vendosin këto në dispozicion të ministrisë;

f) ministria, bazuar në dokumentet më të fundit të promovuara nga Konventa dhe në rrethanat specifike social-ekonomike të vendit, harton metodologjitë kombëtare për përgatitjen e komunikimit kombëtar të BUR-it, NDC-së dhe metodologji të tjera, që nevojiten për zbatimin e këtij ligji, me mbështetjen teknike dhe shkencore të institucioneve që parashikohen në këtë nen. Metodologjitë miratohen me udhëzim të ministrit.

2. Fushat e përgjegjesisë shtetërore, të parashikuara në shkronjat “c” dhe “d” të pikës 1 të këtij neni, përfshijnë: industrinë energjetike, industritë prodhuese, të ndërtimit, të lëndëve djegëse, të minierave dhe gjeologjisë, të pyjeve, biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura, të bujqësisë e blegtorisë, menaxhimit të ujit, mbetjeve, shëndetit, transportit e infrastrukturës (përfshirë atë rrugore e hekurudhore, portet dhe aeroportet, tubacionet, digat, ujin dhe ujërat e zeza), planifikimin urban, menaxhimin e tokës, turizmin, arsimin, emergjencat civile dhe në menaxhimin e fatkeqësive.

3. Me qëllim bashkërendimin e detyrave të ministrive dhe institucioneve publike/private, në përputhje me detyrimet e vendit ndaj Konventës dhe Marrëveshjes së Parisit, ngrihet dhe funksionon grupi ndërministror i punës (Komiteti Kombëtar për Ndryshimet Klimatike) për ndryshimet klimatike, me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.

Neni 24

Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Republika e Shqipërisë merr pjesë në skemën ndërkombëtare të tregtimit të shkarkimeve të GES-it, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, që përshtat mekanizmat ndërkombëtarë të ndryshimeve klimatike dhe udhëzuesit ndërkombëtarë që zbatohen për këtë qëllim.

2. Republika e Shqipërisë merr pjesë në projektet e mekanizmit të zhvillimit të pastër, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, që përshtat mekanizmat ndërkombëtarë të ndryshimeve klimatike dhe udhëzuesit ndërkombëtarë që zbatohen për këtë qëllim.

3. Kontributi Kombëtar i Përcaktuar, sipas nenit 7 të këtij ligji, i komunikohet Konventës deri në fund të vitit të pestë kalendarik pas komunikimit të parë.

4. Dokumenti Strategjik, Plani Kombëtar për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë (NMP) dhe Plani Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP) i komunikohen Konventës në afatet e përcaktuara në vendimet për zbatimin e Marrëveshjes së Parisit.

5. Republika e Shqipërisë përfaqësohet në negociatat ndërkombëtare në kuadër të Konventës dhe integritimit evropian nga ministria, në cilësinë e *focal point* të Konventës dhe institucionit përgjegjës për fushën e ndryshimeve klimatike, në bashkëpunim me ministritë e linjës.

6. Ministritë e linjës, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, bashkëpunojnë me komunitetin ndërkombëtar për zbatimin e Konventës dhe inkurajojnë iniciativat dypalëshe e shumëpalëshe, që synojnë shkëmbimin dhe ndarjen e informacionit për eksperiencat që lidhen me hartimin e politikave e të praktikave të mira ekzistuese, që kontribuojnë për zhvillimin e ekonomive me pak karbon dhe për të mbështetur e përhapur masat që lidhen me klimën.

KREU V

NGRITJA E KAPACITETEVE, EDUKIMI, TRAJNIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE PJESEMARRJA E PUBLIKUT

Neni 25

Ngritja e kapaciteteve

Ministrinë e linjës bashkëpunojnë në mënyrë efektive, eficiente, të integruar e të programuar për ngritjen e kapaciteteve të tyre, të bashkive, të institucioneve financiare, të sektorit privat e të organizatave jofitimprurëse (OJF-ve) për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, sipas fushës së tyre të përgjegjesisë.

Neni 26

Edukimi dhe trajnimi

1. Ministria bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për arsimin për hartimin dhe zbatimin e programeve në fushën e mjedisit e të ndryshimeve klimatike për të gjitha nivelet e arsimit.

2. Ministria bashkëpunon sa herë që i kërkohet nga ministria përgjegjëse për arsimin lidhur me përmbajtjen e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera didaktike dhe nxit pjesëmarrjen e institucioneve arsimore të të gjitha niveleve në iniciativa për kërkime shkencore, edukim dhe trajnim në fushën e mjedisit e të ndryshimeve klimatike në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

3. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për punën bashkëpunojnë për hartimin dhe zbatimin e programeve të edukimit në vazhdim dhe trajnimet në fushën e mjedisit e të ndryshimeve klimatike.

Neni 27

Informacioni dhe ndërgjegjësimi publik

1. Ministrinë e linjës, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, brenda fushave të kompetencave shtetërore përkatëse ndërmarrin fushata informimi për të sensibilizuar e ndërgjegjësuar popullatën për efektet negative të ndryshimeve klimatike, për masat konkrete që mund të marrin për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, në zbatim të kërkesave të këtij ligji dhe objektivave strategjike të vendit në këtë fushë.

2. Fushatat e ndërgjegjësimit i kushtojnë vëmendje të veçantë rolit dhe përfshirjes së grave në përpjekjet për përshtatjen dhe zbutjen ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe grupeve në nevojë apo komuniteteve të prekura.

3. Ministria harton udhëzuesin për integrimin e çështjeve gjinore në programet e zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.

Neni 28

Pjesëmarrja publike

1. Ministrinë e linjës, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, gjatë përgatitjes apo përditësimit të legjislacionit dhe strategjive të tyre në lidhje me klimën, garantojnë pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të interesuar, përfshirë njësitë e qeverisjes vendore, sektorin privat dhe publikun, sipas përcaktimeve të Konventës së Aarhusit dhe legjislacionit përkatës kombëtar.

2. E drejta e publikut për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes për mjedisin përcaktohet në akte ligjore të posaçme.

KREU VI

INVESTIMET DHE FINANCIMET E GJELBËRTA

Neni 29

Nxitja e investimeve miqësore ndaj mjedisit/klimës

1. Ministrinë e linjës dhe bashkitë, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, hartojnë politika që nxisin sektorin publik dhe privat për investime të konsiderueshme që shkarkojnë pak GES, janë transparente, kanë rezultate të parashikueshme, janë pak të ndikueshme nga ndryshimet klimatike dhe inkurajojnë ndërmarrjet, institucionet, grupet sociale dhe individët për të ndjekur dhe për t'iu përshtatur progresit dhe inovacionit teknologjik, zbatimit të rezultateve të shkencës e teknologjisë, zhvillimit të arsimit dhe industrisë, në zbatim të kërkesave të këtij ligji.

2. Ministrinë e linjës dhe bashkitë, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, përditësojnë politikat/dokumentet kombëtare, në mënyrë që të nxisin investimet për projekte miqësore ndaj klimës, mbështesin kërkimin shkencor dhe nxisin praktikën më të mirë në fushat prioritare, si më poshtë:

a) në fushën e prodhimit të energjisë: investimet për energjitë e rinovueshme, shpërndarjen, menaxhimin e shpërndarjes, ruajtjen e energjisë, produktet/teknologjitë që mbështesin sistemet energjetike inteligjente, qendrat e të dhënave për përdorimin e energjive të rinovueshme;

b) në fushën e eficiencës së energjisë: investimet për ndërtesat tregtare të gjelbërta, kreditë për banesa të gjelbërta, teknologjitë dhe produktet me përdorim eficient të energjisë, përmirësimet e teknologjisë;

c) në fushën e transportit: investimet për transportin publik, infrastrukturën për automjete elektrike, skema të qiradhënies së biçikletave, automjete me shkarkime të pakta;

ç) në fushën e ujërave: investimet për përshtatjen ndaj ujërave të shirave/stuhive, investimet për grumbullimin e ujërave të shirave, të trajtimit dhe riciklimit të ujërave, përshtatja e rrugëve ujore; riciklimi i ujërave të përdorura në fermat blegtorale të rritjes dhe mbarështimit të gjedhëve, të imtave dele/dhi, shpendarisë, rritjes dhe mbarështimit të derrave, fabrikat e regjjes dhe përpunimit të lëkurëve;

d) në fushën e menaxhimit të mbetjeve: investimet për kapjen e metanit, shndërrimin e mbetjeve në lëndë djegëse;

dh) në fushën e përdorimit të tokës: investimet për pyjet dhe zinxhirët e furnizimit të qëndrueshëm, bujqësia e qëndrueshme;

e) në fushën e përshtatjes së infrastrukturës: investimet për përshtatjen e infrastrukturës ndaj rritjes së temperaturave, rizhvillimin e porteve për të trajtuar rritjen e nivelit të detit, mbrojtjen nga stuhitë;

ë) në fushën e mbrojtjes së natyrës: praktikat e menaxhimit të përshtatjes për zonat e mbrojtura, vlerësimin e rëndësisë së biodiversitetit në lidhje me kapacitetet e ekosistemeve për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike, duke siguruar, në të njëjtën kohë, nivelin e shërbimeve të ekosistemeve, nga të cilat varet shoqëria njerëzore, vlerësimi dhe analiza e ndikimeve të adaptimit të ndryshimeve klimatike dhe masave zbutëse në biodiversitet.

Neni 30

Transferimi i teknologjive/teknologjitë me pak karbon

1. Ministrinë e linjës, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, dhe autoritetet e tjera kompetente, të përcaktuara në kreun IV të këtij ligji, në fushat e tyre të përgjegjësisë shtetërore:

a) dekurajojnë transferimin e teknologjive të vjetra, inkurajojnë kërkime në shkencë e teknologji, si dhe zhvillimin, transferimin dhe përdorimin e teknologjive, pajisjeve dhe proceseve për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe përshtatjen, me qëllim uljen e vulnerabilitetit ndaj ndryshimeve klimatike, për përmirësimin e performancës mjedisore dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm;

b) inkurajojnë vendosjen e bashkëpunimit ndërkombëtar, që synon dhënien e ndihmës për transferimin e njohurive teknike, të aftësive teknike e menaxheriale për zhvillimin e institucioneve dhe rrjeteve të nevojshme, për sigurimin e pjesëmarrjes së aktorëve privatë dhe publikë;

c) përshtatin standardet e duhura dhe nxisin marrëveshjet vullnetare ndërmjet trupave dhe organizatave që përfaqësojnë interesa të caktuara, grupe operatorësh e operatorë të veçantë dhe autoritetet përkatëse për të nxitur zhvillimin e teknologjive eficiente.

2. Projektet për kërkim, zhvillim, novacion dhe transferim të teknologjive, sipas pikës 1 të këtij neni, do të jenë në përputhje me prioritetet dhe nevojat e përcaktuara në strategjitë sektoriale të zhvillimit me karbon të ulët, në planin kombëtar për zbutje të GES-it dhe programet për mjedisin e klimën.

Neni 31

Përfshirja e sektorit privat

Për të arritur objektivat e reduktimit të shkarkimeve kombëtare të GES-it, të përcaktuara në NDC, ministritë e linjës, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, nxisin përfshirjen e sektorit privat dhe partneritetin me të, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon partneritetin publik privat.

Neni 32

Mekanizmat financiarë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për ndryshimet klimatike

1. Të gjitha autoritetet kompetente, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, nxisin zhvillimin e projekteve e të programeve lokale dhe kombëtare, pjesëmarrjen në projekte, programe rajonale dhe ndërkombëtare, që synojnë arritjen e objektivave për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

2. Ministria përgjegjëse për koordinimin e ndihmës së huaj bashkëpunon me ministrinë dhe ministritë e linjës për të siguruar integrimin e çështjeve të klimës edhe në projekte e programe të tjera, në mënyrë që vendi të përfitojë nga fondet ndërkombëtare respektive.

3. Fondi i mjedisit, sipas ligjit për mbrojtjen e mjedisit, përdoret për të mbështetur zbatimin e masave për zbutje dhe përshtatje, sipas kërkesave të këtij ligji, dhe për të mbështetur prioritetet e dokumenteve politike, kombëtare për ndryshimet klimatike.

4. Mekanizmi i Zhvillimit të Pastër (CDM) i Protokollit të Kiotos mund të përdoret si një kuadër për zbatimin e aktiviteteve të projekteve që synojnë të zbutin shkarkimet antropogjene në Republikën e Shqipërisë.

5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton vendimin për krijimin e Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar të Mekanizmit të Zhvillimit të Pastër (CDM) në kuadër të Protokollit të Kiotos.

Neni 33

Fondi i Gjelbër për Klimën (GCF)

1. Fondi i Gjelbër për Klimën (GCF) është një mekanizëm financimi ndërkombëtar, i krijuar nga Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike për të mbështetur investimet për reduktimin e gazeve me efekt serrë dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, si një kontribut i rëndësishëm dhe ambicioz për të luftuar ndryshimet klimatike.

2. Qasja ndaj Fondit të Gjelbër së Klimës sigurohet nëpërmjet Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar (NDA), si institucioni ndërmjetës midis Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Gjelbër për Klimën.

3. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar udhëheq procesin e përgatitjes së programit kombëtar për ndryshimet klimatike dhe i komunikon Fondit të Gjelbër për Klimën prioritetet kombëtare për të mundësuar financimin e projekteve për reduktimin e gazeve me efekt serrë dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

4. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar (NDA), struktura dhe funksionimi i tij përcaktohen me vendim të Këshilli të Ministrave, me propozimin e ministrit.

KREU VII DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 34 **Kundërvajtjet**

1. Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) zhvillimi i një aktiviteti pa leje mjedisi, që përfshin shkarkimet e GES-it sipas kërkesave të nenit 10 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë, duke u shtuar me vlerën 2 për qind të masës së gjobës çdo ditë deri në korrigjimin e mospërputhjes;

b) mospërmbushja e detyrimit nga cilido operator për monitorimin e shkarkimeve të GES-it dhe raportimin e tyre në AKM, sipas kërkesave të neneve 8, pika 1, dhe 13, pikat 6 e 7, të këtij ligji ose akteve të tij nënligjore, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë, duke u shtuar me vlerën 2 për qind të masës të gjobës çdo ditë deri në korrigjimin e mospërputhjes;

c) mosnjoftimi në AKM i ndryshimeve të parashikuara në pikën 1 të nenit 12 të këtij ligji, për të cilin mund të nevojitet një përditësim i lejes së mjedisit, që përfshin shkarkimet e GES-it lidhur me shkarkimin e këtyre, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë, duke u shtuar me vlerën 2 për qind të masës të gjobës çdo ditë deri në korrigjimin e mospërputhjes.

2. Të drejtën e gjobës për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen e ka inspektorati përgjegjës për mjedisin.

3. Subjekti ndaj të cilit vendoset masa administrative ka të drejtën e ankimit te titullari i strukturës përgjegjëse, sipas afateve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi.

4. Gjoha paguhet brenda një periudhe prej 10 ditësh kalendarike nga njoftimi i saj, përveçse kur vendimi për vënien e saj është pezulluar sipas legjislacionit në fuqi.

5. Ministri, me propozimin e inspektoratit përgjegjës për mjedisin, në rastet kur gjoha nuk është paguar brenda afatit të përcaktuar, vendos pezullimin e lejes përkatëse të mjedisit për të gjithë veprimtarinë apo pjesë të saj deri në pagesën e gjobës, dhe vendimi i pezullimit publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

6. Subjekti ndaj të cilit merret masa e pezullimit ka të drejtën e ankimit sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 35 **Menaxhimi i informacionit**

1. AKM-ja publikon listën e instalimeve të shtojcës II-A, që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Ministria përgjegjëse për transportin publikon listën e operatorëve të avionëve/operatorëve të lundrimit, të licencuar prej saj gjatë vitit të mëparshëm kalendarik dhe që kanë kryer aktivitete aviacioni/lundrimi që mbulohen nga ky ligj, brenda datës 1 shkurt të çdo viti në vazhdim dhe e përditëson këtë listë.

3. AKM-ja mban dhe përditëson regjistrin kombëtar të të dhënave, i cili përmban:

a) listën e operatorëve sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni;

b) vendimet dhe raportet për rezultatet e monitorimit, raportimit e verifikimit të shkarkimeve të GES-it nga operatorët që e kanë këtë detyrim;

c) Raportin Kombëtar të Inventarit të GES-it;

ç) komunikimet kombëtare, raportet e përditësuara dyvjeçare, raportin e NDC-së;

d) analizën e efekteve të zbatimit të dokumenteve strategjike për ndryshimet klimatike;

dh) projeksionet e emetimeve antropogjene të gazeve serrë dhe përthithjen e tyre;

e) investimet dhe mbështetjen financiare për ndryshimet klimatike.

4. Regjistri kombëtar i të dhënave është pjesë e sistemit të informacionit mjedisor.

5. Raportet e shkarkimeve të GES-it, që kërkohen nga leja e mjedisit dhe që mbahen nga AKM-ja, bëhen menjëherë të disponueshme për publikun dhe përditësohen rregullisht duke siguruar akses për të gjithë, në përputhje me vendimin nr. 16, datë 4.1.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor”.

6. Pjesa e të dhënave të parashikuara në këtë nen, që sipas legjislacionit në fuqi klasifikohen si sekret shtetëror apo janë subjekt i legjislacionit në fuqi për të dhënat personale, profesionale e tregtare, trajtohen sipas atij legjislacioni.

Neni 36

Raportimi

1. AKM-ja përgatit raportin për zbatimin e kërkesave për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të GES-it, që kërkohen nga ky ligj dhe aktet e tij nënligjore, çdo vit, pas datës së hyrjes në fuqi të rregullores së parashikuar në pikën 2 të nenit 8 të këtij ligji.

2. Raporti i parë përgatitet pas një viti nga data e hyrjes në fuqi të rregullores së parashikuar në pikën 2 të nenit 8 të këtij ligji, sipas formatit të përmbajtjes së raportit të miratuar me urdhër të ministrit.

Neni 37

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që në zbatim të neneve 5, pika 1; 7, pika 5; 8, pika 2; 13, pikat 2, 4 e 8; 14, pika 2; 15, pika 2; 18, pika 4; 19, pika 2; 21, pika 1; 32, pika 5, dhe 33, pika 4, të miratojë aktet nënligjore brenda 4 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri që në zbatim të neneve 7, pika 4, dhe 27, pika 3, të miratojë aktet nënligjore brenda 4 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Ngarkohet ministria përgjegjëse për mjedisin të rishikojë vendimin në fuqi për formatin për aplikimin dhe aktin e miratimit për leje mjedisi, sipas përcaktimeve në nenet 10, pika 2, e 11, pika 2, të këtij ligji, dhe ta propozojë atë për miratim në Këshillin e Ministrave brenda 6 muajve nga botimi i këtij ligji në Fletoren Zyrtare.

Neni 38

Akte nënligjore që mbeten në fuqi

1. Vendimi nr. 865, datë 10.12.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për reduktimin dhe stabilizimin e shkarkimeve të gazeve serrë të fluorinuara” do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të nenit 17 të këtij ligji.

2. Vendimi nr. 762, datë 16.9.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumentit për përcaktimin e kontributit kombëtar të pikësnyuar kundrejt arritjes së objektivit të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike” do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të nenit 23 të këtij ligji.

3. Vendimi nr. 1553, datë 26.11.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar të Mekanizmit të Zhvillimit të Pastër, në kuadër të zbatimit të

angazhimeve të Protokollit të Kiotos” do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të pikës 5 të nenit 32 të këtij ligji.

4. Urdhri nr. 155, datë 25.4.2014, i Kryeministrit, “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërministror të punës në fushën e ndryshimeve klimatike” do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të këtij ligji.

Neni 39 **Shfuqizime**

Në shtojcën e vendimit nr. 1189, datë 18.11.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, pika 1 e ndarjes “Ç”, “Treguesit mjedisorë të trysnisë në mjedis”, shfuqizohet.

Neni 40 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.12.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11893 , datë 5.1.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

SHTOJCA I GAZET ME EFEKT SERRË, QË REFEROHEN NË NENIN 2, PARAGRAFI 11

1. Dyoksid karboni (CO₂)
2. Metan (CH₄)
3. Monoksid azoti (N₂O)
4. Hegzafluorid i squfurit (SF₆)
5. Trifuorid azoti (NF₃)
6. Hidrofluorokarbone (HFCs) dhe
 - HFC-23 CHF₃
 - HFC-32 CH₂F₂
 - HFC-41 CH₃F
 - HFC-125 CHF₂CF₃
 - HFC-134 CHF₂CHF₂
 - HFC-134a CH₂FCF₃
 - HFC-143 CH₂FCHF₂
 - HFC-143a CH₃CF₃
 - HFC-152 CH₂FCH₂F
 - HFC-152a CH₃CHF₂
 - HFC-161 CH₃CH₂F
 - HFC-227ea CF₃CHF₂CF₃
 - HFC-236cb CF₃CF₂CH₂F
 - HFC-236ea CF₃CHFCHF₂
 - HFC-236fa CF₃CH₂CF₃
 - HFC-245fa CHF₂CH₂CF₃
 - HFC-245ca CH₂FCF₂CHF₂
 - HFC-365mfc CH₃CF₂CH₂CF₃

— HFC-43-10mee CF₃CHFCHFCF₂CF₃ or (C₅H₂F₁₀)

7. Perfluorokarbone (PFCs):

- PFC-14, Perfluoromethane, CF₄
- PFC-116, Perfluoroethane, C₂F₆
- PFC-218, Perfluoropropane, C₃F₈
- PFC-318, Perfluorocyclobutane, c-C₄F₈
- Perfluorocyclopropane c-C₃F₆
- PFC-3-1-10, Perfluorobutane, C₄F₁₀
- PFC-4-1-12, Perfluoropentane, C₅F₁₂
- PFC-5-1-14, Perfluorohexane, C₆F₁₄
- PFC-9-1-18, C₁₀F₁₈

SHTOJCA II

PJESA A

KATEGORITË E AKTIVITETEVE DHE GES-I QË U NËNSHTROHEN KËRKESAVE PËR LEJE MJEDISI QË PËRFSHIN GES-I

1. Instalimet apo pjesë të tyre, që përdoren për kërkim, zhvillim dhe testim të produkteve dhe proceseve të reja dhe instalimet që përdorin ekskluzivisht biomasën, përjashtohen nga ky ligj.


2. Vlerat-prag, që jepen më poshtë, përgjithësisht u referohen kapaciteteve prodhuese ose vëllimit të prodhimit. Për aktivitetet që bien nën të njëjtën kategori dhe kryhen në të njëjtin instalim, kapacitetet e tyre mbledhen së bashku.

3. Për llogaritjen e inputit termal nominal total të një instalimi ku digjen lëndë djegëse, mbledhen inputet termale nominale të të gjitha njësive teknike që janë pjesë e tij. Këto njësi mund të përfshijnë të gjitha tipat e bojlerëve, të pajisjeve për djegie, turbinave, pajisjeve ngrohëse, furnaltave/kaldajave, incineratorëve, kalcinatorëve, furrave të çimentos, furrave të pjekjes, pajisjeve tharëse, motorëve, qelizave të lëndës djegëse, njësive të djegies me fryrje kimike, flakëruesve dhe njësive termale apo katalitike pas djegies. Në këtë llogaritje nuk do të merren në konsideratë njësitë me input nominal termal nën 3 mw dhe njësitë që përdorin ekskluzivisht biomasën. “Njësitë që përdorin ekskluzivisht biomasën” janë njësitë që përdorin lëndë djegëse fosile gjatë ndezjes apo fikjes së njësisë.

4. Kur rezulton se në një instalim që ka një leje mjedisi, kapërcehet pragu i kapacitetit të një aktiviteti që listohet në këtë shtojcë, leja e mjedisit e të gjitha njësive ku digjet lëndë djegëse, përveç njësive për incinerimin e mbetjeve të rrezikshme ose bashkiake, do të ketë edhe kërkesa për shkarkimet e GES-it, sipas nenit 5 të këtij ligji.

No.	Aktiviteti	GES	Kodi i aktivitetit sipas kodit të Shtetësisë të Ligjvënës 1046, datë 14.7.2011 Për llogaritje të menjhëjtë të ndryshimeve
1.	Drejtë e lëndëve dhe të cilave përveç të tjerave për konsumim dhe mbetje të rrezikshme apo të tjerë me sipërfaqe totali më të madhe se 20 MJE	Dioksid karboni	110
2.	Raftimi i rrymave energjetike	Dioksid karboni	120 Rafinimi dhe gazetë minierë përdorues
3.	Produktimi i kokës	Dioksid karboni	130
4.	Përpunimi ose shpërndarja e përfunduar të rëndësive minierë përfunduar të rëndësive	Dioksid karboni	210
5.	Produktimi i gjatë ose i shkurtër i rëndësive të rëndësive përfunduar të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE	Dioksid karboni	220
6.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE. Përpunimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive energjetike të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive	Dioksid karboni	230 250 260
7.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive	Dioksid karboni dhe perforancë karboni	240
8.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE, ID 2.4	Dioksid karboni	240
9.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE, ID 2.5	Dioksid karboni	250
10.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE, ID 2.6	Dioksid karboni	310
11.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE, ID 2.7	Dioksid karboni	310
12.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE, ID 2.8	Dioksid karboni	330
13.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE, ID 2.9	Dioksid karboni	330
14.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE, ID 2.10	Dioksid karboni	1.100 1.100
15.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE, ID 2.11	Dioksid karboni	1.100 1.100
16.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE, ID 2.12	Dioksid karboni	1.100

17.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE, ID 2.13	Dioksid karboni	7.100
18.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE, ID 2.14	Dioksid karboni	7.30
19.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE, ID 2.15	Dioksid karboni dhe oksid azot	4.20
20.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE, ID 2.16	Dioksid karboni dhe oksid azot	4.20
21.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE, ID 2.17	Dioksid karboni dhe oksid azot	4.20
22.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE, ID 2.18	Dioksid karboni	4.20
23.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE, ID 2.19	Dioksid karboni	4.10
24.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE, ID 2.20	Dioksid karboni	4.20
25.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE, ID 2.21	Dioksid karboni	4.20
26.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE, ID 2.22	Dioksid karboni	12.00
27.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE, ID 2.23	Dioksid karboni	12.00
28.	Produktimi i rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive konsumantë të rëndësive të rëndësive të rëndësive të rëndësive me sipërfaqe të mëdha se 20 MJE, ID 2.24	Dioksid karboni	12.00



*Në raste të veçanta, për aplikim për leje mjedisi që përmban edhe kushte për GES-in, operatori mund t'i referohet edhe ndonjë kodit tjetër referuar kolonës 1 të shtojcës 1 të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, i cili nuk është përmendur në tabelën e mësipërme.

PJESA B

LISTA E AKTIVITETEVE TË AVIACIONIT QË PËRJASHTOHEN NGA KY LIGJ, REFERUAR NENIT 13, PIKA 6

<p>a) fluturimet që kryhen ekskluzivisht për transportin për misione zyrtare të një monarku në fuqi dhe familjes së ngushtë të tij, të kryetarëve të shteteve dhe ministrave të vendeve që nuk janë anëtarë të BE-së, kur një gjë e tillë është treguar në planin e fluturimit;</p> <p>b) fluturimet ushtarake që kryhen nga avionë ushtarakë dhe fluturimet e autoriteteve të doganave dhe të policisë;</p> <p>c) fluturimet për misione kërkimi dhe shpëtimi, për shuarje zjarresh, për ndihma humanitare dhe shërbime shëndetësore emergjente të autorizuara nga autoritetet kompetente përkatëse;</p> <p>ç) çdo fluturim që kryhet ekskluzivisht sipas rregullave të shikueshmërisë së fluturimit, sipas përcaktimit të bërë në shtojcën 2 të Konventës së Çikagos;</p> <p>d) fluturimet që përfundojnë në aerodromin e nisjes pa bërë asnjë ulje të ndërmjetme;</p> <p>dh) fluturimet për trajnim që kryhen ekskluzivisht për marrjen e licencës apo për vlerësim në rastin e ekuipazhit të fluturimit, kur kjo është përcaktuar me shënimin e duhur në planin e fluturimit, me kusht që ai fluturim të mos shërbejë për transportin e pasagjerëve dhe/ose kargove, apo për pozicionimin, apo transportimin e avionit;</p> <p>e) fluturimet që kryhen ekskluzivisht për qëllime të kërkimit shkencor apo për kontrollimin, testimin apo certifikimin e avionit apo pajisjeve qoftë në ajër apo në tokë;</p> <p>ë) fluturimet që kryhen nga një avion që ka masë maksimale ngritje të certifikuar prej më pak se 5,700 kg;</p>	<p>Dyoksid karboni</p>
--	------------------------

<p>f) fluturimet që kryhen mbi rrugët ajrore, kur kapaciteti i ofruar nuk është më i madh se 30 000 vende në vit;</p> <p>g) fluturimet që, përveçse në këtë rast, do të binin në aktivitetin e kryer nga një operator tregtar transporti ajror që operon ose:</p> <ul style="list-style-type: none"> - më pak se 243 fluturime në periudhë, për 3 periudha katërmujore konsekuive, - fluturimet me shkarkime totale vjetore më të ulëta se 10 000 tonë në vit. <p>gj) fluturimet që kryhen ekskluzivisht për transportin, për misione zyrtare të një monarku në fuqi dhe familjes së ngushtë të tij, të kryetarëve të shteteve dhe ministrave të vendeve që nuk janë anëtare të BE-së, mund të mos përjashtohen sipas kësaj pike;</p> <p>h) fluturimet që, me përjashtim të kësaj pike, do të binin në këtë aktivitet, që kryhet nga një operator jotregtar avioni, që operon fluturime me shkarkime totale vjetore më të ulëta se 1 000 tonë në vit.</p>	
---	--

SHTOJCA III-A

LISTA JOSHTERUESE E ÇËSHTJEVE QË DUHEN TRAJTUAR NË DOKUMENTIN STRATEGJIK PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

Dokumenti Strategjik për Ndryshimet Klimatike do të përmbajë komponentët në vijim:

1. Pasqyrë të zhvillimit kombëtar dhe politika të ndryshimit të klimës.
2. Kuadri ligjor dhe institucional për zbatimin.
3. Objektivat dhe synimet e përgjithshme të strategjisë:
 - a) vlerësimi i ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe (dobësive) vulnerabilitetin, me synim formulimin e veprimeve prioritare;
 - b) zhvillimi i një strategjie afatgjatë për uljen e emetimit të gazit serrë në paragrafin 19, neni 4 i Marrëveshjes së Parisit;
 - c) plani i mitigimit;
 - ç) plani i përshtatjes;
 - d) plani i menaxhimit të riskut;
 - dh) burimet financiare;
 - e) ndërtim kapacitetesh;
 - ë) burimet financiare;
 - f) edukimi, trajnimi, ndërgjegjësimi.
4. Plan i mitigimit dhe plani i përshtatjes, parashikuar në paragrafin 3, shkronjat “c” dhe “ç” përkatësisht, duhet të përmbajë komponentët e mëposhtëm, sipas rastit:
 - a) përmbledhje:
 - aa) përshkrimi i objektivave dhe masave zbutëse ose adaptuese;
 - ab) përshtatja me planet kombëtare të zhvillimit, si dhe me qëllimet mbi mitigimin sektorial dhe adaptimin;
 - ac) përshkrimi i nismave dhe sinergjive ekzistuese mbi mitigimin ose adaptimin lehtësues ose përshtatjes.
 - b) përfitimet:
 - ba) përshkrimi i përfitimeve në aspektin e zhvillimit (ekonomik, social dhe mjedisor);
 - bb) kosto-efektivitet në arritjen e përfitimeve kombëtare.
 - c) ndikimet nga emetimi i gazit serrë:
 - ca) përshkrimi i skenarit “*business as usual*” (në tekstin e mëtejme: BAU);
 - cb) përshkrimin e ndikimeve të vlerësuara mbi devijimin e emetimit të gazit serrë nga BAU;
 - cc) përshkrimin e impaktit transformues pas zbatimit;
 - cd) kosto-efektivitet në arritjen e ndikimeve të emetimit të gazit serrë.
 - ç) planveprimi:
 - ça) përshkrimi i aktiviteteve të detajuara për zbatimin e masave mitiguese ose adaptuese të përfshira në plan;
 - çb) plani i punës për aktivitetet e detajuara;
 - çc) plani për përfshirjen e palëve të interesuara, duke përfshirë edhe rolin e tyre në zbatimin e aktiviteteve dhe marrëveshjet institucionale.

- d) monitorimi dhe matja e progresit:
- da) përshkrimi i parametrave kryesorë për të vlerësuar progresin e zbatimit të planit;
 - db) përshkrimi i parametrave kryesorë për të vlerësuar përfitimet kombëtare dhe ndikimet e emetimit të gazit serrë;
 - dc) përshkrimi i metodologjisë për të vlerësuar ndikimet e emetimit të gazit serrë, si dhe marrëveshjet për matjen dhe raportimin.
5. Plani i menaxhimit të riskut i parashikuar në paragrafin 3, shkronja “d”, duhet të përmbajë komponentët në vijim:
- a) vlerësimin gjithëpërfshirës të humbjes ekonomike dhe joekonomike dhe dëmeve të lidhura me ndryshimin e klimës, duke përfshirë edhe ato të shkaktuar nga situatat emergjente, si dhe ato ngjarje me fillim të ngadalshëm (*as sell as slow onset events*);
 - b) planin e veprimit për menaxhimin e riskut, duke përfshirë sistemet e paralajmërimit të hershëm, gatishmërisë emergjente dhe masave që synojnë përmirësimin e qëndrueshmërisë së komuniteteve, jetesën dhe ekosistemet;
 - c) masat e menaxhimit të riskut financiar, duke përfshirë edhe lehtësirat e sigurimit të riskut, bashkimit të risqeve të klimës (*climate risk pooling*) ose zgjidhje të tjera të sigurimit.

SHTOJCA III-B
LISTA JOSHTERUESE E ÇËSHTJEVE QË DUHEN TRAJTUAR NË DOKUMENTET
STRATEGJIKE SEKTORIALE
QË REFEROHEN NË NENIN 5

1. Përshkrimin e kontekstit socio-ekonomik, demografik dhe gjeografik për zhvillime me pak karbon.
2. Vlerësimin e shkarkimeve ekzistuese të GES-it, sipas sektorëve dhe shkarkimet e pritshme në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.
3. Vlerësimin e opsioneve teknologjike në sektorë prioritarë.
4. Analizën e mundësive të zbatimit të opsioneve për zhvillime me pak karbon në sektorë të rëndësishëm.
5. Zgjedhjen e opsioneve të duhura për t'u zbatuar në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, në mënyrë që të plotësohen objektivat e përcaktuar në NDC, të referuara në nenin 5.
6. Koordinimin dhe sinergjinë me marrëveshje mjedisore ndërkombëtare/shumëpalëshe, proceset dhe mundësitë për financim.